



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

13.11.2017

NUMRI I DOKUMENTIT	02-035/02-925
DATA E DOKUMENTIT	13.11.2017
NUMRI I KRYETARIT	
NUMRI I ZYRËS	
NUMRI I DOKUMENTIT	
DATA E DOKUMENTIT	
NUMRI I KRYETARIT	
NUMRI I ZYRËS	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr. 28/2008, neni 51 paragrafi 1 të Statutit të komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011 në përputhje me Rregulloren e aprovuar në Kuvendin Komunal të datës 23.12.2016 me numër protokollit 01-013/1706 për subvencione, Kryetari i Komunës bie këtë:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE NË SHUMË PREJ 400,00€**  
**KLUBIT TË SHENJËTARISË “ANAMORAVA”**

**I.**

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **400,00€** me shkronja (katërqind euro) Klubit të Shenjëtarisë “Anamorava” në emër të mbështetjes financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive të këtij klubi.

**II.**

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga fondi burimor 21, kategoria ekonomike subvencione dhe transfero, programi buxhetor Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Shuma e mjeteve prej 400,00€ derdhet në xhirollogarinë e Klubit të Shenjëtarisë “Anamorava”, numër: 1960000408031150.

Obligohet Drejtoria financiar e Klubit të Shenjëtarisë të paraqes raportin me shkrim të mjeteve të shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë

**III.**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

**IV.**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë

Viti, 02.11.2017

**Vendimi u dorëzohet**

1. K. Shenjëtarisë. “Anamorava”
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së Thesarit dhe
4. Arkivit

Kryetari i Komunës së Vitisë  
Sokol HALITI